

VENDIM
Nr. 248, datë 2.5.2012

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 347, DATË 29.4.2011 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË VEPRIMIT
3-VJEÇAR PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË MINERARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 pikat 4 e 8, e 56 pika 1 të ligjit nr. 10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 347, datë 29.4.2011 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Aneksi 1 bashkëlidhur vendimit, pas realizimit të hartës së burimeve minerare, zëvendësohet me aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi, ku jepen të gjitha vendburimet e njohura të mineraleve.

b) Në shkronjën “d” të pikës 1, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Të gjitha zonat minerare të përfshira në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi, duhet të vlerësohen gjatë hartimit të planit vjetor mineral, për vendosjen e tyre në lidhje me sipërfaqet e zonave të mbrojtura, pyjore/kullosore dhe zonat e shfrytëzimit të inerteve lumore. Në rast mbivendosjeje me këto sipërfaqe, përjashtimi ose përfshirja e këtyre zonave në planin vjetor mineral do të bëhet pas marrjes së miratimit nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për sipërfaqet e zonave të mbrojtura, pyjore/kullosore dhe nga KKU-ja për zonat e shfrytëzimit të inerteve lumore.”.

2. Për zonat minerare, në të cilat do të zhvillohet veprimtaria minerare gjatë periudhës 3-vjeçare, të përcaktuara me koordinatë qendre në aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi, përcaktohen për tipin e zonës, konkurruese apo e hapur, koordinatat e zonës dhe të dhënat gjeologjike për të në planin vjetor mineral. Këto zona përditësohen në bazë të informacionit gjeologo-minerar, i cili grumbullohet gjatë kësaj periudhe.

3. Zonat minerare të papërfshira në aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi për të cilat gjatë kësaj periudhe trevjeçare mund të shprehet interes për kërkim-zbulimin ose shfrytëzimin nga subjekte minerare, vendase ose të huaja, në bazë të vlerësimeve të strukturave përgjegjëse, si AKBN-ja, SHGJSH-ja dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, mund të përfshihen në planin vjetor mineral.

4. Zonat minerare të cilat kalojnë në procedurë konkurruese, si dhe zonat e hapura, përfshihen dhe caktohen në planin vjetor mineral, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010. Përcaktimi i zonave në zona konkurruese dhe të hapura bëhet në bazë të vlerësimit të strukturave përgjegjëse, si AKBN-ja, SHGJSH-ja dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha